

AKTUALITET

POLITIKE

BOTA

RAJONI

EKONOMI

KULTURE

SHENDET

LIFESTYLE

KUZHINE

GOSSIP

SPORT

OPINIONE


BREAKING NEWS

AKSIDENTI I RËNDË NË FUSHË KRUJË, REAGON POLICIA: 3 TË VDEKUR, NË GJENDJE KRITIKE EI

AKTUALITET

Shkatërrohet grupi i shpërndarësve të kokainës në kryeqytet, arrestohen 4 persona, sekuestrohen armë, drogë dhe para

SHKRUAR NGA ELVIS MYRTA
23 SHKURT 2020



Policia ka goditur një grup që merrej me shpërndarje të drogërave të forta në kryeqytet, duke arrestuar katër persona dhe shpallur në kërkim organizatorin. Në prangat e bluve të kryeqytetit përfunduan katër të rinj të moshave nga 28 deri në 33 vjeç. Më konkretisht, blutë e Tiranës arrestuan shtetasit me inicialet K. S., 30 vjeç, banues në Tiranë. Ai akuzohet për veprat penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge” dhe “Moskallëzimi i krimit”. E. K., 33 vjeç, banues në Tiranë, i cili akuzohet për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kryer në bashkëpunim”; E. K., 28 vjeç, banues në Tiranë, i akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kryer në bashkëpunim” dhe R. T., 33 vjeç, banues në Tiranë, akuzuar për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”. Arrestimi i tyre u bë i mundur pasi shërbimet e policisë kishin marrë informacione në rrugë operative se këta persona shpërndanin lëndë narkotike kokainë e kanabis në doza të vogla, në zona të ndryshme në Tiranë. Gjatë operacionit në zonën e Selitës, nga kontrolli i ushtruar në banesën e M. Ç., i cili është dhe personi organizator i kësaj veprimtarie kriminale, Policia gjeti dhe sekuestroi tri armë zjarri pistoletë, doza me lëndë narkotike kokainë, 19 aparate celular, 10 ora dore, 600.000 lekë dhe 5000 euro. Gjithashtu, po gjatë kontrollit fizik të ushtruar në parkingun e lokalit të K. S., shtetasve E. K., 28 vjeç dhe E. K., 33 vjeç, Policia u gjeti doza me lëndë narkotike kanabis. Vijon puna për kapjen e 28-vjeçarit të shpallur në kërkim, i cili ka mundur të largohet në momentin e ndërhyrjes nga Policia. Në ditët në vijim personat e arrestuar do të dalin përpara gjykatës ku do të përballen me akuzat e ngritura ndaj tyre.

Operacioni

Operacioni u zhvillua nga Komisarati i Policisë Nr. 2, në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve në DVP Tiranë. “Në vijim të punës për kontrollin e territorit, kapjen e personave që shpërndajnë lëndë narkotike apo që posedojnë armë zjarri dhe si rezultat i një pune disamujore, duke përdorur format e punës që normojnë punën e policisë kriminale, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e ngjarjeve kriminale, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 2, në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe Forcat e Posaçme “Shqiponja” finalizuan operacionin e koduar “Parkimi”, në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve”, sqaroi zyrtarisht policia. Në sajë të këtij operacioni u arrestuan katër shtetas si dhe u shpall në kërkim një 28-vjeçar, i cili dyshohet se është personi që organizonte aktivitetin e paligjshëm. 28-vjeçari i shpallur në kërkim, i cili është me banim në Tiranë do të akuzohet për veprat penale “Armëmbajtje pa leje”, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja e armëve të ftohta” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. “Shërbimet e Policisë kanë marrë informacione në rrugë operative se këta shtetas shpërndanin lëndë narkotike kokainë e kanabis në doza të vogla, në zona të ndryshme në Tiranë. Gjatë operacionit në zonën e Seltës, nga kontrolli i ushtruar në banesën e M. Ç., i cili është dhe personi organizator i kësaj veprimtarie kriminale, Policia gjeti dhe sekuestroi tri armë zjarri pistoletë, doza me lëndë narkotike kokainë, 19 aparate celular, 10 ora dore, 600.000 lekë dhe 5000 euro”, sqaruar uniformat blu. Gjithashtu, po gjatë kontrollit fizik të ushtruar në parkingun e lokalit të shtetasit K. S., shtetasve E. K., 28 vjeç dhe E. K., 33 vjeç, Policia u gjeti doza me lëndë narkotike kanabis. Vijon puna për kapjen e shtetasit të shpallur në kërkim, i cili ka mundur të largohet në momentin e ndërhyrjes nga Policia. Pas përfundimit me sukses të këtij operacioni policia bëri bilancin ku tha se ka sekuestruar tri armë zjarri, lëndë narkotike dhe një shumë parash, e cila dyshohet se është përfituar nga shitja e lëndës narkotike.



E frikshme/ Shkon për të bërë hundën operacion, por fsheh shenjat e koronavirusit, bën 'kërdinë' duke infektuar anestezistin, kirurgun dhe një infermiere
Në kuadër të situatës së krijuar tashmë atje nga koronavirusi si vatra më e prekur në Europë, ka ndodhur një ngjarje e rëndë




Mënyra më e zgjuar për të trajtuar kërpudhat e këmbëve, pezmatimet, kruajtjet dhe skuqjen është më në fund këtu dhe po pret për ne.

Oncosolve | Sponsored




11 Effective Exercises To Get a Flat Belly

Fitness Engage | Sponsored



5 Tips You Need to Know Before Travelling to Cancun

Organic Welcome | Sponsored



7 Best Cruise Deals You Dont want to Miss in Albania

Relocation Target | Sponsored



Amazing ECG Ready Smartwatch Takes Albania By Storm

G7 Smart Watch | Sponsored



Rudina Dembacaj tregon tmerrin që kaloi: Mark Frroku me temperaturë 40.2, dyshojmë për koronavirus



Mjeku kërkesë urgjente Ramës: Pacienti zero, sik pretendoni nuk është gjetur në Shqipëri. Edhe në Itali...



Flight Prices are Down This Week Wednesday

Trips Shop | Sponsored

Më të lexuarat



Deklarata e papritur e mjekut: Koronavirusi është si Cunami, vala e tretë të përpin!



“Nuk do ia uroja askujt”, kontakti i parë i pacientit ‘zero’ përgënjeshtro ish-ministrin e Berishës dhe hedh dyshimet e forta: Na ka stresuar! (Intervista e plotë)



‘Epidemia mund të zgjasë deri në 4 muaj’, mjeku Pëllumb Pipero ua thotë hapur qytetarëve: Ka vetëm një mënyrë si t’a përballojmë koronavirusin



Aksidenti i rëndë në Fushë Krujë, reagon Policia: 3 të vdekur, në gjendje kritike edhe...



Sa mjekë infektionistë ka Shqipëria? Mjeku Tritan Kalo tregon shifrat dhe zbulon si është gjendja e “pacientit 0”



“Arritje e jashtëzakonshme”, OBSH jep lajmin e mirë për vaksinën kundër koronavirusit



Aksident tragjik në Fushë-Krujë, raportohen 4 viktima



Çfarë duhet të kenë parasysh personat që shërojnë nga koronavirusi? Përgjigjet shefja e Epidemiologjisë

Mesazhe Promocionale




SIGMA
INTERALBANIAN
VIENNA INSURANCE GROUP

VIG
VIENNA INSURANCE GROUP



Some friendships transcend lifetime

A DOG'S JOURNEY
MAY 17



A-Class i ri.
Krijuar për Jul

Gossip



■■■■■

Rudina Dembacaj tregon tmerrin që kaloi: Mark Frroku me temperaturë 40.2, dyshojmë për koronavirus
Aktorja Rudina Dembacaj, u shpreh se ajo dhe i dashuri i saj Mark Frroku, kishin...

Opinione

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Ziqiri Mero, simboli i veteranit të luftës dhe ...

NGA BARDHYL BEJKO

Kryeministri sifidant i krizave njerëzore e nat...

NGA RAMAZAN SHERIA

Përsëri jemi para një prove të madhe


LEXO OPINIONET E TJERA

Mesazhe Promocionale



FUNCTIONAL... FASHIONABLE... FORMIDABLE...

FILA



MARANA
BLOODLINE
etnies